



Prishtinë, 15.10.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1063_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 16 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,
- Dispozitat e Nenit 7 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit,
- Kërkesën e KQKO për amendamentimin e Kodit të Rrjetit – Kodi i Planifikimit Operativ të datës 03 gusht 2018,

në seancën e mbajtur me datë 15.10.2018, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** amendamenti i dokumentit “Kodi i Rrjetit - Kodi i Planifikimit Operativ” të KOSTT Sh.a., si në shtojcë të këtij vendimi.

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 04.10.2017 ka pranuar kërkesën e KQKO për amendamentimin e dokumentit “Kodi i Rrjetit – Kodi i Planifikimit Operativ” të harmonizuar me Rregullën për Transparencë 534/2013 të BE-së dhe Rregullat e Tregut. Në këtë kuadër janë shtuar disa pika si edhe është bërë përshtatja e termave sipas legjislacionit në fuqi, përmirësime gjuhësore dhe rregullime të tekstit.
- o ZRRE ka dhënë komente gjatë periudhës amendamentuese si pjesëmarrëse aktive në KQKO, por edhe pas dërgimit të dokumentit për aprovim në ZRRE, të cilat janë përfshirë në dokument.
- o Pas përfshirjes së të gjitha komenteve dhe finalizimit të dokumentit, KQKO me datë 03.08.2018 ka dërguar dokumentin “Kodi i Rrjetit – Kodi i Planifikimit Operativ” në ZRRE me kërkesën për aprovimin e amendamentimit të tij.



- Pas vlerësimit të kërkesës nga KQKO për amandamentim, ZRRE ka aprovuar amandamentimin e dokumentit “Kodi i Rrjetit – Kodi i Planifikimit Operativ”.
- Të gjitha dispozitat tjera të dokumentit “Kodi i Rrjetit -Kodi i Planifikimit Operativ” do të mbesin në fuqi.
- Dokumenti “Kodi i Rrjetit – Kodi i Planifikimit Operativ” ver. 2.4 shfuqizon dokumentin “Kodi i Rrjetit – Kodi i Planifikimit Operativ” ver. 2.3.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t’i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Shtojcë: Dokumenti “Kodi i Rrjetit - Kodi i Planifikimit Operativ” i amandamentuar.

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar